

**Udhëzues për qasjen, që shtrihet në tërë sistemin, për
implementimin e Strategjive Nacionale për Zhvillimin e
Statistikave (SNZhS)**



**PARIS21 Secretariat
31 Tetor 2007**

Përmbajtja:

PARATHENIE

TERMINOLOGJIA

KAPIUTLLI 1: QASJA QE SHTRIHET NE TE GJITHE SISTEMIN

KAPITULLI 2: INICIMI I QASJES

KAPITULLI 3: TE KUPTUARIT E AMBIENTIT NE TE CILIN OFROHET NDIHMA

RAST STUDIMI

RAST STUDIMI: PLANET E SHTETEVE PER MONITORIMIN E AKTIVITETEVE TE MEDSTAT

BIBLIOGRAFIA

ANEKSI 1: MODEL PER PROCEDURA TE PERBASHKETA FINANCIMI

ANEKSI 2: CKA ESHTË QASJA E BAZUAR NE PROGRAM OSE QASJA QE SHTRIHET NE TERE SEKTORIN

ANEKSI 3: APLIKIMI I DEKLARATES SE PARIS MBI EFEKTIVITETIN E NDIHMES NE FINANCIMIN E INVESTIMEVE NE STATISTIKE

Parathënie

Ky dokument është përgatitur në radhë të parë që të shërbejë si udhëzues për menaxherët dhe financuesit e sistemeve statistikore nacionale. Ai ofron udhëzime mbi aplikimin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin si ndihmë për përforcimin e sistemeve statistikore nacionale. Kjo qasje thekson rëndësinë e implementimit të strategjive nacionale për zhvillimin e statistikave (SNZhS), të dizajnuara si duhet, që kanë lidhje direkte me strategjitë nacionale për uljen e varfërisë dhe planet e tjera zhvillimore. Shumë vende kanë dizajnuar, ose janë duke dizajnuar, SNZhS, por çështja kryesore tani është implementimi i strategjive dhe planeve të përgatitura.

Në tryezën e tretë të rrumbullakët mbi menaxhimin për rezultate zhvillimore, të mbajtur në Hanoi në shkurt të vitit 2007, vendet pjesëmarrëse theksuan faktin që sistemi statistikor nacional efektiv dhe efikas është esencial për sigurimin e të dhënave të nevojshme për hartimin e politikave, alokimin e resurseve të kufizuara, matjen e progresit, shfrytëzimin efektiv të ndihmës dhe monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve. Gjatë kësaj tryeze u theksua gjithashtu nevoja për rritjen e përkrahjes në statistikë dhe në mënyrë që kjo të ketë sukses, çdo proces duhet të përfshijë përkrahjen e harmonizuar dhe të koordinuar të donatorëve, në përputhje me Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës.

Është shkruar shumë nga, dhe për, donatorët lidhur me qasjen e bazuar në program, duke përfshirë qasjet që shtrihen në krejt sektorin. Në kuadër të bibliografisë paraqiten burimet e shfrytëzuara, që ofrojnë udhëzues të detajuar, por që përqëndrohen në praktikën e donatorëve. Këta udhëzues kanë për qëllim të ndihmojnë shtetet që të kuptojnë dhe punojnë brenda atyre kornizave të donatorëve, duke aplikuar qasje që shtrihen në tërë sistemin me qëllim të rritjes së përkrahjes së qeverive dhe donatorëve në fushën e statistikës.

Terminologjia

Terminologjia mund të shkaktojë konfuzion pasi organizata të ndryshme përdorin terma të ndryshëm. Termat kryesorë që janë relevantë për qasjen që shtrihet në tërë sistemin janë;

Zyra statistikore nacionale; për qëllime të këtij udhëzuesi, zyra statistikore nacionale në një vend të caktuar i referohet agjensisë statistikore qendrore, duke përfshirë zyret statistikore nacionale, zyret statistikore qendrore, komitetet statistikore të shtetit etj. Zyret statistikore nacionale janë përgjegjëse për aktivitete statistikore specifike, që dallojnë nga vendi në vend, si dhe për koordinimin e përgjithshëm të statistikave zyrtare 2.

2 statistikave zyrtare mblihen, perpilohen dhe shperndahen nga departamente dhe agjensi qeveritare- si nje element i pazevendesueshem ne sistemin e informimit ne nje shoqeri- duke i sherbyer qeverise, ekonomise, dhe publikut te gjere me te dhena mbi gjendjen ekonomike, demografike, sociale dhe ambientale ne vend.

Sistemi statistikor nacional: normalisht i referohet agjensive që janë përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave, edhe më gjerë, trupave zyrtarë që analizojnë dhe shfrytëzojnë statistikave. Ai përfshin produktet statistikore të prodhuara, njerëzit e kyçur në proces, duke përfshirë prodhuesit dhe shfrytëzuesit e statistikave.

Strategjia nacionale per zhvillimin e statistikave: strategjia nacionale për zhvillimin e statistikave është një plan strategjik për zhvillimin e sistemit statistikor nacional - ekuivalent i programit për zhvillimin e sektorit në rastin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin (shih mëposhtë). Tiparet kryesore të një SNZhS sipas PARIS21 paraqiten në tabelën 2.

Qasja e bazuar në program: — *mënyrë përfshirjeje në bashkëpunimin për zhvillim duke u bazuar në parimet e përkrahjes së koordinuar për një program zhvillimor të udhëhequr nga vendorët, siç është strategjia për zhvillim nacional, program për një sektor, program tematik ose program të një organizate specifike* (Komiteti i Asistencës për Zhvillim/Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim).

Qasja e bazuar ne sektor: është një qasje që bazohet në program dhe aplikohet në një sektor të caktuar si shëndetësi, arsim ose bujqësi. Kjo përkrahë programin për zhvillimin e sektorit, që është *“një program i vetëm gjithëpërfshirës dhe kornizë e buxhetit, që përfshin veprime dhe aktivitete specifike, me afate kohore dhe kosto të përcaktuar, në kuadër të sektorit”* si p.sh. në rastin e statistikës, SNZhS që inkorporon edhe resurse nga qeveria edhe nga donatorët.

Qasja që shtrihet në tërë sistemin: është një qasje për përkrahjen e një programi që është nën udhëheqjen dhe pronësinë e vendorëve për zhvillimin e sistemit statistikor nacional në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar, duke u përqëndruar në implementimin e strategjisë nacionale për zhvillimin e statistikës (SNZhS ose dokumente të ngjashme) dhe duke aplikuar procedurat dhe sistemet vendore për implementim. Qasja që shtrihet në tërë sistemin aplikon qasjen e bazuar në program në statistikë si fushë tematike.

Kapitulli 1: Qasja që shtrihet në tërë sistemin

Hyrje

Aplikimi në statistikë i qasjes që shtrihet në tërë sistemin ka për qëllim lehtësimin e rritjes së përkrahjes së qeverisë dhe të donatorëve në fushën e statistikës. Kjo qasje është mbështetur mjaft në përvojat e aplikimit të qasjeve sektoriale, të cilat janë aplikuar me sukses në shëndetësi, arsim dhe bujqësi. Ky është një aplikim tematik i kësaj qasjeje, i orientuar në përkrahjen e një programi të udhëhequr nga vendorët me qëllim të zhvillimit të sistemit statistikor nacional në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar, duke shkuar drejt sistemeve dhe procedurave vendore për implementim. Procesi i përgatitjes së strategjisë statistikore, që mbulon të gjitha, ose së paku pjesët kryesore, të sistemit statistikor nacional, ofron një kornizë në kuadër të së cilës mund të aplikohet qasja që shtrihet në tërë sistemin (që gjithashtu quhet qasje e bazuar në program) për ofrimin e asistencës teknike dhe financiare, të koordinuar dhe të harmonizuar. Statistika është një program tematik, ku mund të aplikohet qasja e bazuar në program ashtu siç është aplikuar në fusha të tjera si HIV/AIDS, siguria e ushqimit dhe ambienti. Komponentet kryesore të kësaj qasjeje janë:

- Një politikë e qartë, strategji dhe program nacional për statistikat zyrtare
- Një kornizë afatmesme e buxhetit, që reflekton strategjinë afatgjate
- Procedurat sistematike për programimin e resurseve
- Një sistem për monitorimin e performancës, që mat progresin dhe rrit llogaridhënien
- Mekanizma konsultimi me të gjitha subjektet relevante, duke përfshirë mekanizmat për dialogje dhe koordinim në të gjithë sistemin statistikor nacional
- Koordinim dhe harmonizim i të gjithë donatorëve nga ana e qeverisë vendore
- Dakordimi rreth harmonizimit të procedurave për buxhetim, menaxhim financiar, prokurim, monitorim dhe vlerësim.

Siç shihet në diagramin mëposhtë (marrë nga OECD: 2006), të gjitha këto komponente çojnë drejt fuqizimit të qëndrueshëm të kapacitetit të institucioneve të sistemit statistikor nacional dhe performancës së tyre në kuptimin e arritjes së rezultateve.



Zhvillimi i kapaciteteve dhe performanca e sistemit statistikor nacional

Si do të jetë ndryshe kjo qasje?

Në disa vende, donatorë të ndryshëm përkrahin pjesë të ndryshme të sistemit statistikor nacional dhe programe të ndryshme në kuadër të institucioneve të sistemit statistikor nacional. Ajo që ndodh është se ka projekte të veçanta të financuara për ndërtimin e kapacitetit statistikor dhe përmirësimit të rezultateve statistikore, por shpesh nuk ka koordinim të mjaftueshëm në mes të projekteve dhe procedurave të ndryshme të donatorëve. Kjo shkakton kosto të larta të transaksionit për vendin dhe për donatorët dhe një situatë e tillë zakonisht është e pavolitshme kur ka resurse të kufizuara, sepse shpesh veprojnë si magnet duke tërhequr resurset e vendit në fushat që përkrahën nga donatorët, pa pasur një pasqyrë të përgjithshme mbi prioritetet për ndërtimin e kapacitetit dhe të rezultateve statistikore. Në anën tjetër, qasja që shtrihet në tërë sistemin synon orientimin e saktë të resurseve duke marrë në konsideratë prioritetet afatmesme për rezultate statistikore dhe ndërtimin e kapacitetit statistikor në të gjithë sistemin statistikor nacional, fuqizon dhe çon drejt shfrytëzimit të procedurave lokale, dhe promovon koordinimin e aktiviteteve të donatorëve nën udhëheqjen e qeverisë vendore, duke përfshirë bashkimin e fondeve dhe përkrahjen e buxhetit sipas nevojës me qëllim të sigurimit të një fleksibiliteti më të madh në shfrytëzimin e fondeve. Donatorët do të përqëndrohen në rezultate dhe jo aq shumë në aktivitete ose procese specifike. Aplikimi i kësaj qasjeje në statistikë përfshin shfrytëzimin e strategjisë nacionale për zhvillimin e statistikave (SNZHS) si një program të vetëm dhe kornizë për koordinimin brenda sektorit dhe mes donatorëve. Qëllimi është që të ketë koherencë të shpenzimeve të qeverisë dhe të donatorëve në fushën e statistikës dhe të reduktohen kostot e transaksionit duke përcaktuar objektivat dhe rezultatet që duhet të arrihen, si dhe duke vendosur mekanizma të përbashkët për implementim, monitorim të progresit dhe raportim.

Pse të adaptohet qasja që shtrihet në gjithë sistemin?

Kjo qasje do të sigurojë një përqëndrim më të madh në çështje strategjike dhe koordinim, dialog më intensiv në gjithë sistemin statistikor nacional dhe përfshirje të të gjitha ministrive relevante, më shumë hapësirë që vetë shteti në fjalë të ketë leadership dhe pronësi, harmonizim të qasjeve dhe përputhshmëri me politikën në vend. Për sa i përket përkrahjes së donatorëve, përvojat tregojnë që ndihma e ofruar nga donatorët është më efektive kur ata punojnë së bashku dhe shmangin projekte të fragmentuara dhe të ndara. Që nga viti 2000, gjithnjë e më shumë vëmendje i është kushtuar strategjive për uljen e varfërisë. Përkrahja në formë të bashkimit të fondeve ka qenë e suksesshme në disa vende. Në vende të tjera, janë aplikuar qasjet e shtrira në tërë sektorin për përkrahjen e implementimit të strategjive nacionale në sektorët kyç si shëndetësia, arsimit dhe bujqësia. Megjithatë, deri vonë, këto qasje nuk janë aplikuar shumë në investimet në kapacitetin statistikor.

Strategjitë Nacionale për Zhvillimin e Statistikave (SNZhS)

Një SNZhS e përgatitur si duhet ka të bëjë me gjithë sistemin statistikor nacional- duke përfshirë krijimin dhe shfrytëzimin e statistikave në ministritë relevante si atë të shëndetësisë, arsimit dhe bujqësisë- dhe jo vetëm krijimin dhe shfrytëzimin e tyre në agjensinë statistikore nacionale. SNZhS ka të bëjë me çështje teknike dhe organizative, institucionale, financiare dhe të kapacitetit të resurseve njerëzore. Vendet që kanë dizajnuar një strategji nacionale të mirë, ose janë në proces të përgatitjes së saj, kanë krijuar bazën për aplikimin e suksesshëm të qasjes që shtrihet në tërë sistemin për implementimin e strategjive nacionale të tyre.

Shumica e shteteve kanë filluar procesin e planifikimit strategjik duke u përqëndruar në zyret statistikore të tyre (siç ilustron me shembullin mbi zhvillimin e kapacitetit të sistemit statistikor në Kenia). Uganda është një shembull tjetër, ku është dizajnuar me sukses dhe ka filluar implementimi i planit strategjik për zyren statistikore të Ugandës, ku është zhvendosur vëmendja në planet zhvillimore për statistikat sektoriale, të cilat u inkorporuan në një strategji koherente për statistikat nacionale. Këta dhe shembuj të tjerë, si dhe proceset e rekomanduara për zhvillimin e një sistemi statistikor nacional koherent, janë theksuar në PARIS21-Intersect-African Development Bank's —Mainstreaming sectoral statistics: a guide to developing an integrated National Statistical System|| 7.

Operacionalizimi i SNZhS: kornizat për shpenzimet

Korniza mbi shpenzimet është ajo që operacionalizon SNZhS. SNZhS duhet të jetë e realizueshme dhe reale, duke identifikuar prioritetet bazuar në vlerësimet e nivelit të resurseve që janë në dispozicion, nga donatorët dhe qeveria vendore. Një SNZhS gjithëpërfshirëse do të përqëndrohet në nevojat për resurse në të gjithë sistemin statistikor nacional, duke përfshirë shpenzimet e përditshme dhe ato kapitale dhe do të demonstrojë se si të arrihet qëndrueshmëria e tyre. Ajo do të adresojë efektivitetin e politikave ekzistuese, rezultateve dhe strukturave institucionale përmes një programi me prioritet dhe kosto të përcaktuar, i cili nuk do të shikohet thjesht si një listë aktivitetesh.

Në mënyrë që të ruajë kredibilitetin dhe integritetin e qasjes, qeveria nuk duhet të kërkojë, dhe donatorët nuk duhet të ofrojnë fonde ose projekte që janë jashtë kornizës së SNZhS dhe që nuk janë në përputhje me prioritetet e saj.

Tabela 1. Nje strategji nationale per zhvillimin e statistikave duhet:

1. Të jetë nën udhëheqjen dhe pronësinë e institucioneve vendore, dhe të ketë përkrahje të lartë politike
2. Të jetë e përqëndruar në nevojat dhe të integruar në politikat e zhvillimit nacional, duke marrë në konsideratë angazhimet regjionale dhe ndërkombëtare të shteteve
3. Të hartohet në mënyrë përfshirëse dhe konsultative
4. Të vlerësojë nevojat e të gjithë sektorëve statistikorë dhe shfrytëzuesve të të dhënave dhe të ofrojë një vizion dhe plan strategjik për statistikën nacionale
5. Të përcaktojë një program për zhvillimin e statistikave, me prioritetet dhe afatet kohore, për ndërtimin e kapaciteteve për arritjen e rezultateve, duke inkorporuar planet për implementim, monitorim dhe vlerësim, por gjithashtu të jetë fleksibil në rast ndryshimi.
6. Të adresojë pengesat dhe proceset institucionale dhe organizative, duke përfshirë resurset, për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemeve statistikore dhe rezultateve
7. Të aplikojë “përshtatjen ndaj qëllimit”, duke mësuar nga përvojat dhe standardet ndërkombëtare
8. Të ndërtojë mbi atë që është bërë dhe vazhdon të bëhet dhe ndërkohë të vazhdojë të pëmbushë nevojat imediate në sistem
9. Të reagojë ndaj nevojave të shfrytëzuesve, por të jetë reale në raport me resurset
10. Të shërbejë si kornizë koherente për përkrahjen ndërkombëtare në zhvillimin e statistikave dhe programeve statistikore në Sistemin Statistikor Nacional

Kapitulli 2: Inicimi i qasjes që shtrihet në tërë sistemin

Sa është e përshtatshme kjo qasje?

Kushti i parë për përshtatshmërinë e aplikimit të kësaj qasjeje është që vetë vendi dhe institucioni qendror (zyra statistikore qendrore) të jenë të interesuar për këtë qasje, si dhe të ketë donatorë që duan të marrin pjesë në procesin e zhvillimit të saj. Do të varet nga vendet dhe partnerët e tyre të zhvillimit që të vendosin nëse kjo qasje është e përshtatshme për nevojat e tyre, por ka më shumë mundësi që ajo të jetë e suksesshme në vendet me aktivitete statistikore më pak të zhvilluara, në vendet që kanë hartuar SNZhS, ose janë në proces të hartimit të saj, në vendet me nevoja të mëdha për përmirësime në kapacitetin statistikor dhe me kapacitet të mirë menaxhues.

Çfarë do të nevojitet?

Faktorët më të rëndësishëm janë:

1. Një strategji nacionale reale dhe e dizajnuar mirë (SNZhS ose dokument të ngjashëm), afatgjate, padyshim që është një kusht i nevojshëm për një qasje të koordinuar në zhvillimin statistikor, por jo edhe i mjaftueshëm. Foster dhe Fozzard (2000) kanë theksuar që — edhe financimi i konsiderueshëm i një programi ose projekti në një sektor mund të mos sjellë rezultate të qëndrueshme nëse nuk ka një politikë të mirë mbi sektorin në fjalë.

2. Pronësi dhe lidhësi i qartë brenda sistemit statistikor nacional dhe niveleve të larta qeveritare, duke përfshirë përkrahjen e Ministrisë së Financave. Qasja që shtrihet në tërë sistemin është më efektive aty ku përgatitja e një SNZhS ka lindur brenda qeverisë, në nivel të lartë, dhe aty ku procesi ka mandat të qartë.

3. Pjesëmarrja aktive e të gjithë donatorëve që ofrojnë përkrahje në fushën e statistikës në vend duke çuar drejt koordinimit të përkrahjes së donatorëve nga vetë qeveria në hartimin e SNZhS

4. Integrimi i SNZhS në planifikimin më të gjerë në nivel nacional dhe në proceset që kanë të bëjnë me buxhetin (siç janë strategjitë për uljen e varfërisë dhe kornizat mbi shpenzimet).

5. Të siguruarit që SNZhS definojnë dhe merret me të gjithë sistemin e gjerë statistikor: prioritet në SNZhS duhet dhënë nevojave të sektorit dhe duhet të merret parasysh përkrahja ekzistuese dhe ajo e planifikuar nga donatorët në sistemin statistikor nacional.

6. Të siguruarit që SNZhS identifikon rezultatet kryesore dhe parimin e përshtatjes ndaj qëllimit për ofrimin e një platforme reale për zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të statistikave nacionale, duke adresuar gjithashtu nevojat imediate për të dhëna për progresin e zhvillimit.

7. Të siguruarit e strukturës për menaxhim dhe koordinim në të gjithë sektorin statistikor nacional përmes – p.sh. përmes një Këshilli Statistikor.

8. Vendosja e strukturave uniforme të implementimit dhe procedurave të prokurimit, menaxhimit financiar dhe monitorimit para fillimit të implementimit, duke

shfrytëzuar një kornizë të përbashkët të përcaktuar dhe duke shkuar drejt mbështetjes më të madhe të donatorëve në sistemet lokale financiare dhe llogaridhënese.

9. Përcaktimi i mekanizmave adekuatë financimi varësisht nga rrethanat në një vend të caktuar.

10. Sigurimi i një sistemi adekuat monitorimi dhe vlerësimi.

Si të inicohet kjo qasje?

Vendet (dhe donatorët) duhet të jenë të përkushtuar për aplikimin e kësaj qasjeje në implementimin e plotë të SNZhS. Kur bëhet fjalë për vendet, kjo përfshin këto parakushte:

1. Është përgatitur, ose është duke u përgatitur, një strategji e mirë statistikore me përkrahjen e nivelit të lartë politik;
2. Ministri i financave ose ministri përgjegjës i dërgon një kërkesë komunitetit të donatorëve ku kërkon përkrahje në implementimin e strategjisë nacionale për zhvillimin e statistikave dhe propozon aplikimin e qasjes së bazuar në program.
3. Resurset e nevojshme janë identifikuar, ose do të identifikohen, në kornizat nacionale për resurse, si kornizat mbi shpenzimet afatmesme
4. Janë hapur bisedimet me përfaqësues të donatorëve lokalë
5. Të gjithë donatorë (ose së paku donatorët kryesorë) që kanë interes në përkrahjen e statistikave kanë rënë dakord për këtë qasje dhe njëri donator është identifikuar si udhëheqës i procesit të koordinimit dhe bisedimeve me qeverinë
6. Janë identifikuar iniciativat ekzistuese në fushën e statistikës dhe është e qartë mënyra se si do të përfshihen ato në qasjen e bazuar në programe.

Cilat kapacitete ose faktorë të tjerë duhet të ekzistojnë dhe/ose të zhvillohen?

- lidhshipi, pronësia dhe përkushtimi politik.
- Menaxhimi financiar: fuqia dhe transparenca e procese të qeverisë mbi buxhetin dhe sistemet e kontabilitetit dhe auditimit.
- Kapaciteti absorbues dhe implementues i resurseve njerëzore dhe institucioneve: ekspertiza profesionale dhe kualifikimi i personelit; aspektet organizative, strukturat, procedurat dhe rutinat, korniza institucionale, duke përfshirë ligjet, politikat dhe kulturën institucionale, aftësia për të realizuar ndryshime.
- Monitorimi dhe vlerësimi: kapaciteti për të monitoruar dhe raportuar rezultatet.
- Integrimi i programit statistikor në strategjitë për ulje e varfërisë.
- Shkalla e përfshirjes së donatorëve; ekzistimi i mekanizmave të udhëhequr nga qeveria për koordinimin e donatorëve.
- Mekanizmat për konsultim dhe arritjen e konsensusit në mesin e donatorëve.
- Kapaciteti për të vazhduar programet ekzistuese dhe për të ofruar shërbime.

Në të gjitha këto fusha duhet të ndërtohen ose zhvillohen kapacitetet. Disa vende do të duhet të dizajnojnë strategjitë nacionale për zhvillimin e statistikave (SNZhS) dhe për këtë proces mund t'u nevojitet përkrahje e koordinuar e donatorëve në formë të asistencës teknike dhe/ose financiare. Të gjitha ministritë relevante, ose disa prej tyre, do të kenë kapacitet të mangët dhe do të kenë nevojë për kujdes të veçantë në

zhvillimin e kesaj qasjeje. Ndryshimi merr kohë dhe mund të jetë i mundimshëm. Programet nuk duhet të jenë shumë ambicioze dhe është e rëndësishme të shikohen mundësitë për disa arritje të shpejta, që do të motivonin procesin në fjalë. Një ndër beneficionet e qasjes që shtrihet në tërë sistemin është se donatorët përqëndrohen në përdorimin dhe ndërtimin e kapacitetit të sistemit nacional për planifikim, menaxhim, implementim, monitorim dhe vlerësim të ndihmës që ata ofrojnë. Duhet të analizohen kapacitetet dhe nevojat në të gjitha këto fusha si pjesë e përgatitjes së qasjes që shtrihet në tërë sistemin.

Potenciali për nje qasje me faza

Disa aspekte të qasjes në fjalë mund të realizohen më shpejt se disa të tjera – p.sh. koordinimi më i mirë mes donatorëve duhet të arrihet sa më shpejt që është e mundur në të gjitha vendet- kurse për realizimin e disa aspekteve të tjera fillimisht duhet të ndërtohen kapacitetet e nevojshme, p.sh. kapaciteti për menaxhimin e qasjes. Këshilli Evropian ka propozuar një kornizë logjike për zhvillimin e qasjeve të bazuara në programe, të cilat mund të jenë relevante për statistikë. Në aplikimin e këtij modeli në statistikë, si fushë tematike jotradicionale, prioritetet janë këto:

- Faza 1 – hartimi i politikës adekuate, kornizës për menaxhim, kornizës afatmesme mbi buxhetin, vendosjen e mekanizmave për SNZhS, të udhëhequr nga qeveria, dhe proceseve të koordinimit dhe bashkëpunimit mes donatorëve. Pasi të plotësohen këto elemente, mund të thuhet se është vendosur baza për programin që shtrihet në të gjithë sistemin. Sipas Këshillit Evropian, përvojat tregojnë se vetëm atëherë bëhet i mundur adresimi serioz i çështjes së cilësisë së sistemeve menaxhuese të programit.||

- Faza 2 – përfshin këto komponente: sistemin e monitorimit të performancës, mekanizmat e konsultimit me shfrytëzuesit dhe subjektet e tjera relevante, dhe harmonizimin e sistemeve për raportim, buxhetim, menaxhim financiar dhe prokurim (këtu nuk duhet anashkaluar vlerësimin e nevojave të shfrytëzuesve të të dhënave si pjesë kyçe e procesit të dizajnit të SNZhS).

Një rrezik që duhet të evitohet është shkëputja në mes të dizajnit të SNZhS dhe implementimit të saj. Çështja e mekanizmave të implementimit (duke përfshirë financimin) duhet të zgjidhet gjatë dizajnit të SNZhS.

Mekanizmat për dialog dhe koordinim

Qasja që shtrihet në tërë sistemin kërkon mekanizma zyrtarë, të udhëhequr nga qeveria, për dialog dhe koordinim: (1) në të gjithë sistemin statistikor nacional, (2) me shfrytëzuesit ose shfrytëzuesit potencialë të statistikave, dhe (3) me subjektet e tjera relevante, duke përfshirë donatorët. Aty ku nuk ekzistojnë këta mekanizma, ose janë të dobët, procesi i zhvillimit të kësaj qasjeje do të ndihmonte përforcimin e tyre.

Normalisht, Këshilli Statistikor ose Komiteti për Koordinimin e Sistemit Statistikor Nacional do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e sistemit statistikor nacional, duke përfshirë këshillat mbi harmonizimin e aktiviteteve statistikore. Një trup i

tillë do të duhej të kishte zyrtarisht termat e referencës dhe kriteret për nëngrupet, takimet e rregullta, përgjegjësitë udhëheqëse dhe përgjegjësitë e tjera. Dialogu dhe koordinimi në mes të donatorëve, i udhëhequr nga qeveria, do të jenë të ndara nga koordinimi i sistemit statistikor nacional me qëllim të lehtësimit të konsultimit, arritjes së konsensusit dhe vendimmarrjes mes partnerëve, që janë të kyçur në financimin e qasjes në fjalë. Të gjitha këto do të përcaktoheshin me marrëveshje në mes të partnerëve. Konsultimi me të gjitha subjektet relevante duhet të jetë një element që duhet pasur parasysh gjatë dizajnit dhe implementimit të SNZhS, duke përfshirë pjesëmarrjen në procesin e monitorimit dhe të vlerësimit.

Monitorimi dhe vlerësimi (edhe i ndërtimit të kapacitetit statistikor, edhe i programeve zhvillimore në përgjithësi)

Monitorimi dhe vlerësimi duhet të mbulojnë disa dimensione të implementimit të SNZhS, si mëposhtë:

- Implementimin e SNZhS dhe të planit të punës, duke përfshirë funksionimin e mekanizmave për konsultim dhe koordinim në të gjithë sistemin statistikor nacional.
- Sistemet e financimit dhe të menaxhimit
- Funksionimin e partneritetit në përkrahje që qasjes që shtrihet në tërë sistemin
- Inputet, aktivitetet, outputet
- Rezultatet e nivelit më të lartë, duke përfshirë rezultatet në ndërtimin e kapacitetit
- Ndikimin final të strategjisë, duke përfshirë qëllimet në kuptimin e uljes së varfërisë

Kjo mund të arrihet duke caktuar disa indikatorë për programin e statistikave dhe matjen e progresit. Gjatë përzgjedhjes së indikatorëve duhet shikuar se cilët indikatorë janë të arsyeshëm për ata që kanë interes në arritjen e rezultateve. Ata mund të përqëndrohen në rezultatet finale siç paraqiten nga qëllimet zhvillimore të mileniumit dhe në strategjitë për uljen e varfërisë, si dhe indikatorët e zhvillimit institucional dhe proceseve të tjera, si pjesëmarrja e subjekteve relevante, me anë të të cilëve shoqëria civile kërkon llogaridhënie nga qeveria.

Zhvillimi i kapacitetit statistikor është i gjerë dhe është pjesë e nevojës për të zhvilluar kapacitetet e monitorimit dhe vlerësimit të programeve të qeverisë dhe të donatorëve për zhvillim në përgjithësi. Zhvillimi i kapaciteteve për monitorim dhe vlerësim kërkon mund të madh në ndërtimin e kapaciteteve në disa fusha. CIDA ka vëzhguar (2003) që zhvillimi i kapacitetit në nivel individual, të organizatës dhe të sistemeve, dhe zhvillimi i mjeteve të sofistikuara për menaxhimin e programeve të ndërlikuara, është një proces afatgjatë që merr së paku 10 vjet punë. CIDA ka identifikuar çështjet e mëposhtme që kanë të bëjnë me kapacitetet, të cilat duhet të adresohen në raport me monitorimin dhe vlerësimin:

- Strategjitë për uljen e varfërisë janë shumë ambicioze në kuptimin e indikatorëve dhe caqeve. Mbledhja e informacioneve të nevojshme është e hendikepuar

nga mungesa e kapaciteteve për të gjeneruar informacione për shkak të vjetërimit të të dhënave nga regjistrimi i popullsisë, sistemeve të dobëta statistikore dhe metodave ose aftësive të pamjaftueshme për mbledhjen e informatave të besueshme.

□ Shpërndarja e informacioneve në ministri dhe entitete të ndryshme (p.sh. mes ministrive dhe institucioneve të tyre).

□ Kapacitete dhe resurse të mangëta për analizimin dhe shfrytëzimin e informatave.

□ Mungesa e koordinimit ose lidhjes në mes të prodhuesve të informatave dhe shfrytëzuesve të tyre.

Kapitulli 3: Të kuptuarit e ambientit në të cilin ofrohet ndihma

—Ajo që mund të ofrojë një donator është përkrahja teknike dhe financiare, dhe më e rëndësishmja, gatishmëria për të qenë fleksibil në aranzhmanet e tyre, gjë që do të mundësonte reduktimin e kostove të transaksioneve dhe do të rriste efektivitetin. Në anën tjetër, donatorët do të presin llogaridhënie më të madhe në nivel lokal. (CIDA 2003)

Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës

Në Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës (Mars 2005, shih aneksin 3), donatorët zotohen të përkushtohen për harmonizim, përputhshmëri dhe menaxhim të ndihmës që ofrojnë me qëllim të arritjes së rezultateve të matshme. Përputhshmëri do të thotë që donatorët do të punojnë për zhvillimin e kapacitetit dhe pronësisë qeveritare, duke mbështetur përkrahjen e tyre në politikat dhe planet nacionale për menaxhimin e ofrimit të ndihmës. Harmonizimi i referohet aranzhmaneve të përbashkëta mes qeverisë dhe donatorëve, p.sh. strategjitë e përbashkëta mbi asistencën dhe/ose shfrytëzimi i instrumenteve të caktuara të ndihmës si bashkimi i fondeve ose përkrahja e buxhetit. SNZhS ofron një kornizë për qeveritë për zhvillimin e sistemeve statistikore nacionale të tyre, dhe për donatorët një kornizë për përkrahjen e këtyre përpjekjeve duke u bazuar në parime të caktuara brenda kontekstit të Deklaratës së Parisit.

Instrumentet e ndihmës

Vetë qasja që shtrihet në tërë sistemin nuk ofron ose nuk kërkon një mekanizëm të ri për ofrimin e asistencës nga donatorët. Donatorët që nuk mund të kontribuojnë në bashkimin e fondeve kanë aplikuar qasje të bazuara në programe duke i përshtatur projektet e tyre prioriteteve të paraqitura nga qeveria.

Ekzistojnë tre mekanizma kryesorë për financimin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin; secili nga këta mekanizma ka përparësitë dhe të metat e veta, por zgjedhja finale do të varet nga rrethanat që dominojnë në një vend të caktuar:

1. Bashkimi i të gjitha fondeve – ndoshta është zgjidhja më e mirë për koordinimin dhe monitorimin, duke qenë marrësi përgjegjës për administrim dhe raportim;

2. Bashkimi i disa fondeve të donatorëve, me kontribute të tjera që menaxhohen veçmas; dhe

3. Financimi paralel ku partnerët bëjnë marrëveshjet me marrësin e ndihmës. Kjo i jep më shumë fleksibilitet donatorit dhe marrësit, por koordinimi i financimit dhe i aktiviteteve mund të jetë më i vështirë.

Vendimi për llojin e instrumentit të ndihmës që ofrohet nga një donator i caktuar do të varet nga politika e tyre mbi ndihmën, mirëpo në raste të caktuara kjo ka mundësi të varet nga perspektiva e tyre mbi politikën dhe llogaridhënien e qeverisë në përgjithësi dhe në raport me sistemin statistikor nacional, nga dizajni i SNZhS dhe kapaciteti për ta implementuar atë, nga ambienti organizativ dhe institucional, nga besimi në procedurat e qeverisë për menaxhimin financiar. Fondet mund të jenë në formë huaje, kredie ose granti. Zakonisht, mund të shfrytëzohen aranzhime të ndryshme të ofrimit të asistencës, duke përfshirë përkrahjen e projekteve dhe programeve, si bashkimi i fondeve dhe përkrahja e buxhetit, ose kombinimi i këtyre.

Gjithashtu, donatorët mund të vazhdojnë të përkrahin programe individuale, si statistikat ekonomike ose sistemin e informimit shëndetësor, ose aktivitete të mëdha si regjistrime të popullsisë.

Implementimi i SNZhS do të zgjasë me vite dhe ka mundësi të përfshijë më shumë se një fazë financimi nga donatorët. Gjithashtu, ka shumë mundësi që donatorë të ndryshëm të ofrojnë përkrahje në mënyra të ndryshme dhe kohë të ndryshme, varësisht nga cikli financiar i donatorëve. ***E rëndësishme është që të gjitha këto ndihma të jenë në përputhje me kornizën e SNZhS.***

Përkrahja e projektit

Përkrahja e projektit në kontekstin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin nuk duhet të kuptojë biznesin siç kuptohet kjo fjalë zakonisht. Vazhdimësia dhe parashikueshmëria e fondeve janë esenciale. Me qëllim që të evitohen mangësitë e projekteve të fragmentuara, ato duhet:

- Të vendosen brenda kontekstit të SNZhS
- Të koordinohen me donatorët e tjerë, nën udhëheqjen e qeverisë me qëllim të zvogëlimit të kostove të transaksioneve
- Të adresojnë zhvillimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve
- Të përdorin procedurat lokale, aty ku është e mundur
- Të përqëndrohen në implementimin e SNZhS
- Të përdorin agjensitë donatore në vend vetëm për të përkrahur institucionet vendore, dhe jo për të menaxhuar në mënyrë aktive të gjitha aspektet e projektit.

Përkrahja e programit

Përkrahja e programit dallon nga ajo e projektit me atë se përfshin përkrahje të natyrës më të përgjithshme, që mund të përdoren lirshëm për qëllime të ndryshme, në kuadër të fondeve të bashkuara. Fondet mund të jenë nga buxheti ose jashtë tij, që do të thotë se mund të jenë nga ose jashtë buxhetit të qeverisë, dhe mund të menaxhohen, ose jo,

sipa procedurave lokale. Gjithashtu mund të përfshijë destinimin e fondeve për lloje specifike të aktiviteteve. Përkrahja e programit në kuadër të qasjes që shtrihet në tërë sistemin ka mundësi të ofrohet ose në formë fondesh të bashkuara ose në formë të përkrahjes së buxhetit.

(1) Bashkimi i fondeve ('shporta e përbashkët')

Bashkimi i fondeve i referohet situatës kur disa donatorë merren vesh që të kontribuojnë në një fond të përbashkët. Kjo zakonisht përfshin shfrytëzimin e një llogarie të rezervuar për qëllime të caktuara, sipas marrëveshjes në mes të qeverisë dhe donatorëve që janë pjesë e këtij fondi të përbashkët. Bashkimi i fondeve kërkon procedura të qarta dhe të harmonizuara, si dhe vëzhgim nga të gjithë donatorët që janë pjesë e fondit. Harmonizimi dhe koordinimi i procedurave në fondin e përbashkët mund të bëhet me një nga dy mënyrat. Ose kontributet e donatorëve integrohen në sistemin e buxhetit të qeverisë ose përdoren disa procedura të donatorit, p.sh. procedurat e Bankës Botërore mbi menaxhimin e fondeve në emër të donatorëve të tjerë bashkëfinancues nën marrëveshjen mbi fondin e mirëbesimit. Këshilli Evropian ka paraqitur përparësitë potenciale të krijimit të një fondi të përbashkët:

- —Mund të reduktohen kostot e transkacioneve duke realizuar në mënyrë të përbashkët raportimin, kontabilitetin dhe procedurat mbi aktivitetet, që ndryshe do të financoheshin përmes disa projekteve diskrete.

- Duke menaxhuar aktivitetet e disa donatorëve sipas një procedure financimi, procesi i harmonizimit me politikën e qeverisë mund të jetë më i lehtë.

- Kjo mund të sigurojë një bazë të mirë për fitimin e besimit në mes të qeverisë dhe donatorëve, duke lehtësuar kështu përkrahjen e buxhetit dhe aplikimin e procedurave të qeverisë.

Megjithatë, Këshilli Evropian tërheq vërejtjen edhe ndaj faktit që ky model mund të shkaktojë kosto të transaksionit që mund të tejkalojnë benefitet, nëse nuk adaptohet një formulë e caktuar. Prandaj, propozohet që të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i mundësisë për të shkuar direkt drejt përkrahjes së buxhetit.

(2) Përkrahja e buxhetit

Përkrahja e buxhetit është një përkrahje e programit, që i ofrohet institucioneve vendore në një vend që të shpenzohet si pjesë e buxheteve të tyre dhe duke u bezuar në procedurat e tyre mbi menaxhimin e financave. Edhe pse përkrahja e buxhetit përfshin edhe bashkimin e fondeve, ajo dallohet nga bashkimi i fondeve me përzierjen e fondeve të donatorëve me ato të marrësit të përkrahjes dhe me fleksibilitetin më të madh që ajo i jep qeverisë vendore në shfrytëzimin e këtyre fondeve. Para se të ofrohet përkrahje e buxhetit, donatorët duhet të sigurohen për rregullsinë e sistemit të menaxhimit financiar të institucioneve vendore, përkushtimin e tyre ndaj politikave të shëndosha dhe kapacitetin e tyre për të realizuar ato.

Bashkëpunimi teknik (ose asistenca teknike)

Bashkëpunimi teknik nënkupton shpërndarjen e ekspertizës përmes personelit (konsulentë dhe specialist të tjerë), trajnimeve dhe takimeve, njohurive dhe

hulumtimeve. Qëllimi është të transferohen njohuritë dhe të kontribuohet në zhvillimin e kapaciteteve të vendeve në zhvillim. Për përkrahjen e qasjes që shtrihet në tërë sistemin mund të ofrohet asistencë teknike e pavarur, megjithatë një pjesë e asistencës teknike në këtë fushë do të ofrohet nga stafi i vendit donator ose grupeve të shteteve të caktuara (p.sh. stafi i shteteve evropiane ose Commonwealth), edhe pse tendenca është drejt transferimit të kompetencave për bashkëpunim teknik tek qeveritë dhe bashkëpunimit më të madh rajonal. Donatorët mund të vazhdojnë të mobilizojnë stafin e tyre në fushat ku ata kanë ekspertizë të konsiderueshme si pjesë e raporteve më të gjera në mes të dy vendeve, p.sh. në formë të procesit të binjakëzimit.

Tabela 2: Disa thënie interesante mbi ndihmën efektive:

□ Mbi promovimin e pronësisë: —Ajo që ka rëndësi në arritjen e një zhvillimi të vazhdueshëm nuk ka të bëjë aq shumë me faktin se kush është 'në ulësen e shoferit', por sa janë të përkushtuar të gjithë ata që ndodhen në makinë për të arritur në destinacionin e caktuar.

□ Mbi zhvillimin e kapacitetit: —Donatorët duhet të synojnë aplikimin e praktikave të mira, por e rëndësishme është të përcaktohet se çfarë është praktikë e mire për rrethanat në një vend të caktuar, me theks të veçantë në të mësuarit duke vepruar. ||

□ Mbi bashkëpunimin teknik: —...duhet të luhet një rol aktiv nga (stafi nga vendi donator) në fushën e zhvillimit të kapaciteteve. Kjo nuk duhet të përfshijë patjetër shitjen e shërbimeve të tyre, por kërkon kontaktin e tyre me shoqëritë e tjera gjë që do t'i mundësonte (stafit nga vendit donator) luajtjen e një roli katalitik dhe mbështetës në fushat ku ata janë më përpara në kuptimin e zhvillimit.

□ Mbi monitorimin dhe vlerësimin: —...donatorët dëshirojnë të bartin përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit tek vendet në zhvillim atëherë kur ka rritje të kompleksitetit të programimit për zhvillim.

Dokumente mbi qasjen që shtrihet në tërë sistemin

Një model mbi aranzhimet e përbashkëta të financimit paraqitet në aneksin 1.

Rast studimi: Zhvillimi i kapaciteteve të Sistemit Statistikor Nacional në Kenia Në vitin 2002, pas ndërrimit të qeverisë, kishte një mundësi për ndryshim. U bënë bashkë disa faktorë, si: emërimi i drejtorit të ri të Byrosë Qendrore Statistike (BQS), që kishte vizion të qartë për ndryshim, qeveria e re me mandat dhe përkushtim për një qeverisje më të hapur dhe më transparente, ri-kyçja e donatorëve me nevojën për të planifikuar dhe programuar projektet e tyre të ndihmës, dhe nevoja për hartimin e një strategjie për uljen e varfërisë. Në statistikë ishin të pranishëm dy donatorë kryesorë DFID dhe Banka Botërore, por edhe shumë partnerë të tjerë ishin të interesuar dhe të gatshëm për ofrimin e përkrahjes financiare dhe teknike. ***Përgatitja e planit strategjik dhe planit të implementimit*** Në vitin 2003, me përkrahjen financiare të DFID-it dhe Bankës Botërore përmes një fondi mirëbesimi, Qeveria e Kenias ka përgatitur një Plan Strategjik për BQS. Për përgatitjen e kësaj strategjie u realizua një proces i gjerë konsultimesh dhe u dhanë disa rekomandime: fuqizimi i legjislacionit të ri për statistikat, sipas të cilit BQS transformohet në një agjensi gjysmë-autonome, të mbikqyrur nga një bord i pavarur,

vendosja e mekanizmave për koordinimin e statistikave zyrtare të gjeneruara nga agjensi të tjera qeveritare, zhvillimi i shkathtësive të fuqisë punëtore, investimi në infrastrukturë dhe implementimi i planeve për përmirësim për seritë kryesore të të dhënave. Kabineti miratoi Planin Strategjik dhe rekomandimet kryesore të tij në vitin 2003 dhe Qeveria hyri në dialog me donatorët për krijimin e një pakoje për financimin e implementimit të këtij plani. Qeveria i kërkoi ndihmë zyrtarisht Bankës Botërore për implementimin e planit. Hapat e ardhshëm të procesit u përcaktuar përmes një projekti të përbashkët të Bankës Botërore dhe DFID-it. Si prioritet kryesor u identifikua përgatitja e një plani të detajuar për implementimin e strategjisë, duke përfshirë një program pune të detajuar, me prioritetet të qarta, me kosto të përcaktuara, që ka lidhje me kornizën mbi shpenzimet afatmesme.

Gjithashtu, u vendos që në planin e implementimit të përcaktohen afatet për aktivitetet dhe rezultatet kryesore dhe të specifikohet se si të monitorohet progresi i implementimit. Plani Strategjik përqëndrohej kryesisht në BQS. U tha që duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje zhvillimit të Sistemit Statistikor Nacional si tërësi. Në planin e implementimit do të theksohej se si do të zhvillohet Sistemi Statistikor Nacional dhe çfarë duhej të bëhej jo vetëm në kuadër të BQS, por edhe të agjensive të tjera partnere. Duke pasur parasysh këto çështje, BQS formoi një ekip për përgatitjen e një Master Plani për implementim dhe, aty ku ishte e nevojshme, u ofrohej asistencë teknike agjensive partnere për t'u ndihmuar në identifikimin e nevojave dhe planeve të tyre. Përmes një projekti regjional, që ofronte ndihmë për vendet që do të merrnin pjesë në Sistemin e FMN për Diseminimie e të Dhënave, u ofrua asistencë teknike për përgatitjen e strategjisë për përmirësimin e shfrytëzimit të të dhënave nga regjistrimi i ngjarjeve vitale dhe për ofrimin e ndihmës agjensive juridike dhe të sigurisë (gjykatat, burgjet, shërbimi i paraburgimit) në krijimin e një sistemi për përpilimin e statistikave nga dosjet administrative. Plani u përfundua në fund të vitit 2003 dhe në fund të po këtij viti dhe në maj të vitit 2004 u realizuan misionet të përbashkëta vlerësimi. Në planin e detajuar të implementimit përcaktohej edhe buxheti, duke përfshirë shpenzimet e vazhdueshme dhe ato kapitale.

Funksionimi operacional dhe i financimit nga donatorët Në vitin 2004 u mbajt një takim pune me të gjitha subjektet relevante, duke përfshirë agjensi donatore, për të diskutuar implementimin e planit strategjik. U vendos që BQS të formonte një njësi për implementimin e projektit dhe mekanizmat për menaxhimin e prokurimit dhe financave, dhe të raportonte rregullisht mbi progresin. Në përgjithësi, të gjithë donatorët u pajtuan që të punojnë me këtë njësi dhe të aplikojnë procedurat e saj për menaxhimin e përkrahjes së tyre. Donatorë të ndryshëm aplikuan qasje të ndryshme për ofrimin e përkrahjes financiare për planin strategjik p.sh. DFID-i ofroi përkrahje të buxhetit, për komponentet kryesore të planit strategjik, si dhe për aktivitetin kyç Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare të Kenias. Banka Botërore, në bashkëpunim me Qeverinë, përgatiti një projekt për hua për investime, duke përdorur kornizën e projektit të mëparshëm, STATCAP. Donatorë të tjerë aplikuan qasje të tjera. Praktikisht, kjo siguroi fleksibilitet të dobishëm. Për arsye të ndryshme, që nuk kanë të bëjnë me vetë projektin e STATCAP, miratimi i kredisë u vonua për më shumë se 18 muaj. Megjithatë, kjo nuk e vonoi shumë implementimin pasi DFID-i ishte në gjendje të siguronte fonde për një periudhë të shkurtër kohore dhe Banka Botërore të ofronte disa fonde në avans.

Situatë aktuale (mesi i vitit 2007)

Deri në mes të vitit 2007 ka pasur mjaft përparime. Në shtator të vitit 2006 kaloi Akti mbi Statistikat, që u bë ligj në shkurt të vitit 2007, gjë që mundësoi që BQS të menaxhohet nga një bord, përgjegjës, mes të tjerash, edhe për koordinimin e zhvillimit të sistemit statistikor nacional. Qeveria emëroi anëtarët e bordit, duke përfshirë kryesuesin e tij, dhe drejtori i BQS u emërua drejtor general. Akoma ka procese që duhet të kryhen me qëllim të menaxhimit të tranzicionit të BQS dhe vendosjes së strukturave qeverisëse. Kredia e STATCAP të Bankës Botërore filloi në gusht të vitit 1997 dhe vazhdoi përkrahja nga donatorët e tjerë. Në të njejtën kohë u shtuan dispozitat buxhetore mbi statistikën pak a shumë në përputhje me planin strategjik. Për sa i përket të dhënave u publikuan dy raportet e para, duke përfshirë një profil të ri mbi varfërinë. Është ofruar përkrahje për disa agjensi dhe nevojat e tyre janë inkorporuar në programet dhe planet vjetore të punës. Së fundi, me formimin e bordit, u përshtatën edhe strukturat dhe procedurat e koordinimit të brendshëm. Edhe pse mbetet shumë për të bërë dhe akoma ka sfida përpara, është krijuar një bazë e mire dhe vazhdon të jetojë përkushtimi për realizimin e ndryshimeve.

Mësimet e nxjerra

Duke shikuar procesin si ka shkuar në Kenia, mund të nxirren disa mësimet, të cilat mund të jenë të dobishme për vendet e tjera derisa ato i nënshtrohen procesit të zhvillimit të qasjes që shtrihet në tërë sistemin për përmirësimin e statistikave. Mësimet kryesore janë:

- Nevoja për lidhshmëri të fortë dhe identifikimi i nevojës për ndryshime brenda sistemit statistikor. Kjo nuk mund të sigurohet nga jashtë.
- Nevoja për të përfituar nga ndryshimet në ambientin e jashtëm, p.sh. ndërrimi i qeverisë në vitin 2002.
- Nevoja që një ose dy donatorë të marrin rolin kryesor në punën me qeverinë. Në Kenia këtë rol e morën Banka Botërore dhe DFID-i.
- Nevoja për t'i dhënë kohë të mjaftueshme realizimit të proceseve të planifikimit strategjik dhe përcjelljes së rezultateve. Në Kenia kaloi më shumë se 18 muaj derisa u përfundua Plani Strategjik dhe SIMP.
- Nevoja që donatorët të kenë përkushtim afatgjatë në fushën e statistikave.
- Nevoja për fleksibilitet, sidomos në ofrimin e përkrahjes financiare nga donatorët.
- Nevoja për krijimin e strukturave për koordinim dhe shkëmbim të informacioneve, por gjithashtu nevoja për fleksibilitet në mënyrë që këto të ndryshohen kur paraqiten rrethana të reja.
- Edhe pse formimi i një njësie të veçantë për implementimin e projektit nuk siguron plotësisht aplikimin e procedurave dhe sistemeve të qeverisë, ajo ofron një kornizë të përbashkët, e cila me kalimin e kohës mund të ofrojë një orientim më të madh për donatorët drejt mbështetjes në sistemet dhe procedurat lokale financiare dhe llogaridhënëse.

Rast studimi: Përforsimi i Sistemit Statistikor Nacional në Taxhikistan

Taxhikistan, një vend me 6.8 milion banorë dhe GDP 2.1 billion dollarë amerikanë, u pavarësua në vitin 1991. Menjëherë pas pavarësimit, lufta civile që shërtheu shkaktoi shumë dëme fizike dhe njerëzore në vend. Pas arritjes së paqes, mesi i vitit 1997, Qeveria përqëndroi vëmendjen e saj në reformimin ekonomik dhe social. Një ndër fushat që donte të reformonte Qeveria ishte sistemi statistikor nacional, ku Komiteti Statistikor i Shtetit (KSSh) dhe divizionet e tij në nivel lokal janë agjensitë publike përgjegjëse për përpilimin, kontrollimin, analizimin, agregimin, diseminimin dhe ruajtjen e të dhënave statistikore. Në Taxhikistan, çështja e statistikave bazohet në Ligjin mbi statistikat e shtetit, i vitit 1997, i plotësuar në vitet 2001 dhe 2003.

Përgatitja e planit strategjik dhe planit të implementimit. Në vitin 2000, si hap i parë drejt modernizimit, KSSh deklaroi programin e integruar reformues, program 3 vjeçar, për statistika, i cili koïncidoi me planin 3 vjeçar të Qeverisë për reformat në fushën e ekonomisë. Qeveria miratoi programin, që përfshinte edhe çështjet në vijim:

- Rritjen e kualifikimit të stafit
- Aplikimin e teknologjisë modern në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.
- Aplikimin e metodave moderne për përzgjedhjen e mostrës

- Përdorimin e gjerë të metodologjive statistikore shkencore për përlogaritje dhe kalkulime
- Dokumentimin e të dhënave për publikun

Disa nga detyrat e përshkruara nuk u realizuan, ose u realizuan pjesërisht, por shumë prej tyre ngelën pa u përfunduar për shkak të mungesës së fondeve. Në vitin 2002, KSSH kërkoi ndihmën e Bankës Botërore në zhvillimin e kapaciteteve të tij dhe përgatitjen e një strategjie për statistika dhe një plani të veprimit afatmesëm, dhe aplikoi për një grant nga Fondi i Mirëbesimit për ndërtimin e kapaciteteve statistikore. Banka Botërore miratoi propozimin për grant dhe në vitin 2003 u nënshkrua marrëveshja mbi grantin. KSSH implementoi me sukses projektin, i cili përfundoi me kohë në vitin 2005. U përpilua një plan shumëvjeçar statistikor i integruar (MISP), që është ekuivalent il SNZhS, për të gjithë sistemin statistikor nacional, përfshirë ministritë dhe agjensitë relevante, që ofruan planet e tyre për pesë vitet e ardhshme. Në mars të vitit 2005, Qeveria miratoi këtë plan dhe kërkoi ndihmë nga Banka Botërore për implementimin e tij. Banka Botërore iu përgjigj pozitivisht kësaj kërkesë dhe u formua ekipi i projektit. Ekipi i projektit i Bankës Botërore dhe KSSH dizajnuan projektin në formë Kredie Specifike për Investime, nën kornizën e STATCAP Adaptable Program për zhvillimin e kapacitetit statistikor përmes qasjes që gjerë sektoriale, duke shfrytëzuar programin statistikor shumë vjeçar të integruar si bazë për investime. Përgatitjet filluan në fund të vitit 2005 dhe projekti u miratua nga Banka Botërore në maj të vitit 2006 dhe filloi në qershor të vitit 2006.

Partneritetet

IDA ka lidhur partneritetet me donatorët për të ndihmuar KSSH në implementimin e projektit. DFID dhe SIDA janë partnerët e tjerë në këtë projekt dhe ofrojnë përkrahje në vlerë prej £600,000, respektivisht 17.1 milion Kroner suedeze. Të dy donatorët kanë rënë dakord për vendosjen e kontributeve të tyre në një fond mirëbesimi, të menaxhuar nga Banka Botërore, pa e destinuar në mënyrë specifike për implementimin e projektit. Pra, u formua një fond mirëbesimi për përforcimin e sistemit statistikor nacional në Taxhikistan. Turkish International Cooperation Agency (TICA) gjithashtu ofron përkrahje për projektin në formë të trajnimeve në fusha të ndryshme të statistikës në Turqi, si dhe duke siguruar ekspertë për periudha të shkurta dhe të gjata kohore. Implementimi i projektit gjithashtu do të koordinohet dhe monitorohet nga të gjithë partnerët me anë të vlerësimeve, që janë cekur qysh në fillim në marrëveshjet administrative me donatorët partnerë. Eurostat është një partner tjetër në implementimin e projektit. Edhe pse nuk kontribuon në mënyrë direkte, Eurostat ka ndarë €300,000 për aktivitete të ndryshme, që do të realizohen në vitin 2006 dhe kanë lidhje direkte me aktivitetet e projektit. Ekipi i projektit ka koordinuar me Eurostatin të gjitha aktivitetet e projektit që nga fillimi i tij. Ekipi i projektit gjithashtu ka koordinuar të gjitha komponentet e projektit me FMN, FAO, UNICEF dhe Bankën Zhvillimore Aziatike me qëllim të evitimit të duplikimeve dhe rritjes së efektivitetit të implementimit. Që nga fillimi janë mbajtur takime me të gjithë partnerët relevantë.

Strukturat institucionale dhe kushtet e implementimit

Duke pasur parasysh që projekti synon përmirësimin e gjithë sistemit statistikor nacional në vend, kërkohet që të sigurohet përkrahja dhe përkushtimi i mjaftueshëm i agjensive dhe ministrive të ndryshme të qeverisë. Për të siguruar një gjë të tillë, Qeveria ka formuar një Këshill Drejtues të Projektit (KDP). Këshilli ka si kryesues Këshilltarin e Presidencës për Politikën Ekonomike, dhe anëtarë si: kryesuesin e Komitetit Statistikor të Shtetit, zëvendësministrit e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, që janë të informuar për projektin, dhe udhëheqësin e njësisë për koordinimin e ndihmës. Përgjegjësitë e KDP-së janë:

Sigurimi i bashkëpunimit në mes të departamenteve dhe ministrive dhe zgjidhja mes tyre e çështjeve të ndryshme;

Miratimi i planeve për implementimin e projektit;

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të projektit çdo gjashtë muaj;

Raportimi 2 herë në vit para qeverisë lidhur me gjendjen e implementimit të projektit dhe, nëse është e nevojshme, paraqitja e rekomandimeve për përmirësim.

KSSH do të jetë trupi kryesor ekzekutiv i projektit dhe do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe implementimin. Me qëllim të implementimit efektiv dhe kryerjes së punëve të përditshme administrative, është formuar një ekip për koordinimin e projektit deri në 5 anëtarë. Ky ekip, duke përfshirë një ekspert në menaxhimin e projektit, një specialist për menaxhim financiar, një për prokurim dhe një asistent, është punësuar nga KSSH. Kjo njësi koordinon aktivitetet e përditshme të projektit, menaxhon raportimin dhe auditimin e aktiviteteve dhe siguron aplikimin e procedurave dhe politikave mbi prokurimin dhe menaxhimin financiar. Ekipi i raportit kryesuesit të KSSH.

Aktualisht (2007) projekti implementohet nga një konsorcium i përbërë nga pesë agjensi statistikore të zhvilluara (Gjermani, Suedi, Danimarkë, Republika Çeke dhe Sllovakia). Përvojat nga projektet për zhvillimin e kapaciteteve statistikore, të implementuara në vendet e tjera, tregojnë që marrëveshja në mes të KSSH dhe konsorciumit do të ishte qasje më e mirë se angazhimi i disa firmave konsulente ose konsulentëve të ndryshëm individualë. Është parashikuar që në periudhën afatgjatë kjo do të sigurojë një partneritet, që mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit.

Mësimet e nxjerra. Që nga fillimi, edhe KSSH edhe Qeveria kanë ndier përgjegjësi për projektin dhe kanë ofruar gjithë përkrahjen e nevojshme. Vetë shpejtësia e realizimit të procesit është një indikacion i qartë i këtij përkushtimi, ku të gjithë hapat e procesit kaluan pa vështirësi në të dyja anët. Një indikator tjetër i përgjegjësisë dhe përkrahjes së Qeverisë është fakti që Qeveria kontribuoi me 17% të kostos totale të projektit. Gjithashtu, duhet të theksohet se strategjia për zhvillim nacional e Taxhikistanit, e miratuar në vitin 2006, i kushtoi vëmendje të posaçme KSSH dhe përgjegjësive të tij në monitorimin dhe vlerësimin e prioriteteve të kësaj strategjie. Është e rëndësishme të theksohet se ekipi për koordinimin e projektit nuk është një ekip që funksionon ndaras siç ndodh në shumë projekte që financohen nga donatorë. Ky ekip do t'i ndihmojë stafit të KSSH në implementimin e projektit, por nuk do ta implementojë vetë atë. Kjo do të bëhet në përputhje me Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës, politikën e Bankës Botërore mbi implementimin e projektit dhe rekomandimet Government/World Bank/Asian Development Bank Country Portfolio Performance Review.

Rast studimi: Programe statistikore shumë vjeçare për vendet që kanë hyrë në BE

Procesi i hyrjes në BE obligon shtetet që të plotësojnë disa standarde statistikore në fushat e përcaktuara (the *acquis communautaire*). Këto shtete janë ndihmuar në plotësimin e standardeve të nevojshme përmes programeve statistikore shumë vjeçare të integruara (MISP), një formë e SNZhS, me qëllim të zhvillimit të sistemit statistikor nacional në secilin shtet. Implementimi i këtyre programeve të integruara përfshinte plane vjetore të punës, bazuar në fushat prioritare, duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës statistikore si sistemet e klasifikimit sipas standardeve ndërkombëtare, statistikat ekonomike, financiare dhe sociale, teknikat si përzgjedhja e mostrës ose përshtatjet sezonale, dhe sistemet më të mira të shpërndarjes së informatave. Në secilën fushë të intervenimit, janë ndërmarrë vlerësime vjetore të shkallës së zbatimit të standardeve të BE-së dhe pengesave për zbatimin e këtyre standardeve, të progresit të planifikuar gjatë vitit, dhe rezultateve të pritura në fund të vitit. Çelësi i suksesit në këto shtete ishte përkushtimi politik për arritjen e *acquis communautaire* si pjesë e procesit të hyrjes në BE dhe ekzistimi i resurseve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore. Gjithashtu, për sa i përket *acquis communautaire*, u përcaktuan disa pika referimi drejt të cilave shtetet zhvillonin procesin e tyre.

Mësimet e nxjerra Ky shembull demonstroi rëndësinë e lidershit dhe përkushtimit politik, si dhe ekzistimin e një programi, të përkrahur në mënyrë të koordinuar nga donatorët, sidomos nga Komisioni Evropian.

Rast studimi: Planet e shteteve për monitorimin e aktiviteteve të MEDSTAT

MEDSTAT është një program statistikor bashkëpunimi në mes të Bashkimit Evropian dhe 10 vendeve mediterane partnere, duke përfshirë: Algjerinë, Egjiptin, Izraelin, Jordanin, Lebanin, Morokon, Autoritetin Palestinez Authority, Sirinë, Tunizinë dhe Turqinë.

Një shembull tjetër i kontributit të Këshillit Evropian në implementimin e qasjes që shtrihet në tërë sistemin është zhvillimi i planeve të shteteve me qëllim të krijimit të një mjeti monitorues për aktivitetet e MEDSTAT. Këto plane janë përgatitur me qëllim të të paraqiten aktivitetet e programit në mënyrë të qartë, transparente dhe të artikuluar dhe të integrohen në Strategjitë Nacionale për Zhvillimin e Statistikave (SNZhS), duke marrë parasysh të gjitha burimet e jashtme të përkrahjes. Mirëpo, ky mjet nuk vlen vetëm për programet e MEDSTAT, ai është mjaft fleksibil sa t'i përshtatet të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e statistikave në vend, qofshin ato të inicuar dhe koordinuar nga subjekte vendore ose me përkrahje nga jashtë.

Bibliografia

Adrienne Brown, Mick Foster, Andy Norton, and Felix Naschold (2001). —The Status of Sector-wide Approaches, Overseas Development Institute Working Paper 142.

Canadian International Development Agency (2003). —CIDA Primer on Program-based approaches.

United Kingdom Department for International Development (2007). —Guidance on Aid Instruments: a DFID Practice Paper.

European Commission (2003). —Guidelines for European Commission Support to Sector Programmes.

European Commission (2007). —Support to Sector Programmes|| in Tools and Methods series, guidelines number 2.

Foster M. (2000). —New Approaches to development Cooperation: What Can We Learn from Experiences with Implementing Sector-Wide Approaches? ODI Working Paper 140.

Foster M. and Fozzard A. (2000). —Aid and Public Expenditure: A Guide. ODI Working Paper 141.

OECD, et al. (2004). *Marrakech Action Plan for Statistics*, Second International Roundtable on Managing for Development Results, Marrakech, Morocco.

OECD (2006). *Harmonising Donor Practices for Effective Aid Delivery*. —Chapter 3: Sector-wide Approaches.

Paris Declaration on Aid Effectiveness (2005).

PARIS21. —A guide to designing a National Strategy for the Development of Statistics.

PARIS21-Intersect-African Development Bank (2007). —Mainstreaming sectoral statistical systems in Africa: a guide to planning an integrated National Statistical System.

Uganda Plan for National Statistical Development (2006)

United Nations (1994). —Fundamental Principles of Official Statistics, UN Statistical Commission.

United Nations (1999). —Some guiding principles for good practice in technical cooperation for statistics, UN Statistical Commission.

World Bank and PARIS21 Secretariat (2007). —Scaling up investment in National Statistical Systems: a note on applying a system-wide approach to implementing National Strategies for the Development of Statistics.

Aneksi 1: Modeli për procedurat financiare të përbashkëta

1. Qëllimet e programit dhe shtrirja e procedurave të përbashkëta financiare
 - a. Të bazuarit në qëllimet/objektivat e SNZhS
 - b. Kushtet dhe procedurat e përcaktuara se bashku për përkrahjen e SNZhS
 - c. Donatorët do të lidhin marrëveshje bilaterale në përputhje me procedurat e përbashkëta financiare
 - d. Përkrahja do të bazohet në progresin e implementimin, që matet me anë të indikatorëve të përcaktuar

2. Përgjegjësitë dhe përfaqësimi:
 - a. Përshkrimi i përgjegjësive të Ministrisë/zyres përgjegjëse për implementimin e SNZhS dhe menaxhimin e përkrahjes financiare të donatorëve
 - b. Kushtet specifike përpara lëshimit të fondeve
 - c. Donatorët të gatshëm për parimet mbi harmonizim dhe parashikueshmëri të përkrahjes
 - d. Përkushtim për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave

3. Kontributet:
 - a. Sasia dhe afatet kohore të realizimit të detyrimeve
 - b. Procedurat për kanalizimin e kontributeve p.sh. në kuadër të buxhetit ose në një llogari bankare të veçantë (nëse nuk veprohet sipas sistemit buxhetor)

4. Konsultimet, vendimmarrja:
 - a. Programi dhe procedurat për konsultime të rregullta, duke përfshirë udhëheqjen e takimeve
 - b. Informacionet / raportet e nevojshme, nga kush/ deri kur
 - c. Temat kryesore që do të diskutohen gjatë konsultimeve
 - d. Procedurat e mbajtjes së procesverbalit
 - e. Procedurat për organizimin e takimeve plotësuese

5. Struktura organizative:
 - a. Komitete dhe përgjegjësi të përbashkëta
 - b. Koha dhe qëllimi i takimeve
 - c. Pjesëmarrësit dhe udhëheqësi i takimit

6. Procedurat e pagesave (varësisht se a aplikohen apo jo procedurat e sistemit buxhetor):
 - a. Mekanizmat e pagesave për plotësimin e nevojave buxhetore dhe qarkullimit të parasë me qëllim të implementimit të SNZhS
 - b. Donatorët të specifikojnë kohën e realizimit të pagesave në marrëveshjet bilaterale
 - c. Kushtet e caktuara përpara realizimit të pagesave
 - d. Vlerësimi i performancës

7. Prokurimi:

a. Rregullat e prokurimit qoftë sipas rregullave, udhëzuesve ose procedurave të Qeverisë ose rregullave të tjera të përcaktuara, (varësisht se a aplikohen apo jo procedurat e qeverisë);

8.

Raportimi

a. Qeveria ofron informacione mbi implementimin e SNZhS, në bazë të indikatorëve për performance, p.sh. raporte mbi ekzekutimin e buxhetit, raporte financiare mbi implementimin e SNZhS, raporte auditimi (nëse vepohet sipas sistemit të qeverisë mbi monitorimin)

b. Raporte mbi kohën dhe përmbajtjen e progresit fizik dhe financiar (që mundësojnë krahasimin e buxhetit me progresin aktual), problemet e hasura ose të parashikuara dhe informata të tjera relevante për procesin e implementimit

9. Rishyqrtimi dhe vlerësimi:

a. Nëse vepohet sipas sistemit të qeverisë për raportim dhe monitorim: vlerësim për të gjithë donatorët, në përputhje me procesin qeveritar për vlerësim; vlerësime të përbashkëta nga qeveria dhe të gjithë donatorët, të cilat përkrahin proceset nacionale mbi buxhetin dhe i kontribuojnë dialogut mbi politikat dhe proceseve të vendimmarrjes të donatorëve

b. Nëse nuk mund të vepohet sipas procedurave të qeverisë: specifikimi I kohës dhe përmbajtjes së rishqyrtimeve/vlerësimeve të përbashkëta, sa më shumë që është e mundur; konsultime kur një donator i caktuar duhet të ndërmarrë vlerësime unilaterale

10. Auditimi:

a. Specifikimi i kushteve të auditimit

b. Nëse vepohet sipas rregullave dhe ligjit të qeverisë për llogaridhënie, duhet të përgatiten raportet përkatëse

c. Nëse nuk mund të vepohet sipas këtyre procedurave: p.sh. qeveria kontraktton një auditor të pavarur, përcakton kohën dhe natyrën e raporteve; kontraktimi i një auditori të pavarur i pranueshëm për donatorët

11. Moszbatimi:

a. Procedurat për suspendimin e pagesave në rast të mos zbatimit ose shkeljes serioze të parimeve: takim me donator të tjerë dhe qeverinë

b. Në rastet, përveç përkrahjes direkte të buxhetit, procedurat për suspendimin dhe kthimin e fondeve të transferuara; takim donator të tjerë dhe qeverinë

12. Korrupsioni:

a. Dispozita për stafin dhe konsulentët lidhur me shmangien e kërimit ose ofrimit të dhuratave, kompenzimeve ose beneficioneve të tjera, të cilat do të mund të interpretoheshin si praktika ilegale ose korruptive

13. Modifikimi, ardhja e donatorit të ri dhe tërheqja:

a. Procedurat për diskutime vjetore mbi implementimin, aplikimin dhe efektivitetin e procedurave në JFA

b. Procedurat për modifikim

c. Procedurat për kyçjen e donatorëve të rinj

d. Procedurat për tërheqjen/përfundimin e përkrahjes (dhe takimi për të diskutuar)

14. Zgjidhja e kontestit:

a. Procedurat e konsultimit në rast kontesti

15. Hyrja në fuqi:

a. Data e nënshkrimit

Aneksi 2: Çfarë është qasja e bazuar në programe ose qasja që shtrihet në të gjithë sektorin?

Qasja e bazuar në program dhe sektor ka disa vite që po aplikohet në fushat e shëndetësisë, arsimit dhe të bujqësisë. Një përkufizim i pranueshëm gjerësisht i kësaj qasjeje është se kjo paraqet një mekanizëm për financimin e përfundimit të kapacitetit dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimit në një sektor, ku *“... të gjitha fondet përkrahin politikën e një sektori të vetëm, nën udhëheqjen e qeverisë, duke adaptuar qasje të përbashkëta për tërë sektorin dhe duke u mbështetur në procedurat e qeverisë për shpenzimin e fondeve dhe llogaridhënies për to.”* Përkufizime të tjera të njohura janë: me këtë qasje mbulohet i gjithë sektori; një kornizë koherente e politikës; subjektet vendore udhëheqin procesin; përfshirje e të gjithë donatorëve, që janë të kyçur në sektor; aplikim i procedurave të përbashkëta të implementimit; dhe asistencë teknike afatgjate minimale. Edhe pse termit qasje që shtrihen në tërë sektorin ose qasje që shtrihen në tërë sistemin janë përdorur në sektorin e shëndetësisë ose arsimit, kohëve të fundit është përdorur termi qasje e bazuar në program, sidomos për programe të gjera siç është zhvillimi rural. Deri tani, ky term nuk është aplikuar për projekte dhe programe që kanë për qëllim zhvillimin statistikor, edhe pse ka disa projekte që do të hynin pikërisht në kuadër të këtij përkufizimi. Brown dhe të tjerë theksojnë që, sipas përvojës, qasja që shtrihet në tërë sistemin është një qasje për financimin dhe implementimin e projekteve zhvillimore dhe jo vetëm qasje e një plani të thjeshtë.

Çfarë përfshin ky proces?

Praktikisht, procesi drejt qasjes së bazuar në program nënkupton formulimin e një strategjie, me kosto të përcaktuar dhe reale në kuptimin e resurseve që janë në dispozicion, dhe përgatitjen e një plani për implementim, në formë marrëveshjeje me burimin e fondeve, që përfshin edhe format e monitorimit të performances. Zakonisht, këto aktivitete nuk ndodhin në formë lineare dhe disa prej tyre mund të zhvillohen paralelisht. Gjithashtu, është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes të vetë qasjes, e cila ofron një bazë për raportet në mes të vendit dhe donatorëve, dhe aranzhimeve specifike të financimit. Shumë programe aktuale përfshijnë aranzhime të ndryshme financimi, që varen nga shkalla e konsensusit në mes të qeverisë dhe partnerëve të saj të zhvillimit, si dhe në mes të këtyre partnerëve mes vete, nga kostot dhe beneficionet e instrumenteve të ndryshme, nga kapaciteti i agjensive vendore për arritjen e rezultateve dhe llogaridhënia e këtyre agjensive para subjekteve të tyre relevante.

Është e rëndësishme të theksohet që implementimi mund të zgjasë me vite dhe mund të përfshijë më shumë se një fazë financimi nga donatorët. Nuk do të thotë që të gjitha

fondet të ofrohen gjatë një periudhe; në fakt, ka më shumë mundësi që përkrahja nga donator të ndryshëm të ofrohet sipas orareve të ndryshme, varësisht nga ciklet e tyre të financimit. Ajo që është e rëndësishme është vazhdimësia dhe parashikueshmëria e fondeve. Përvojat e aplikimit të kësaj qasjeje në fushat e tjera tregojnë që është esenciale që të gjithë donatorët të përfshihen në stadet e hershme të procesit dhe të marrin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e strategjisë.

Cilat janë beneficionet? Në përgjithësi, kjo qasje ka tendencën të përqëndrohet më shumë në rezultatet, që rrjedhin nga një proces i gjerë konsultimi. Beneficionet potenciale, që rrjedhin nga programme që shtrihen në tërë sektorin dhe që dizajnohen dhe implementohen me kujdes, janë këto:

- E para, pronësia dhe lidhshipia më i forte i shtetit rrit mundësitë për të pasur sukses dhe përfitime, duke përfshirë qëndrueshmërinë institucionale.
- E dyta, aftësia për të tejkaluar çështjet kryesore me të cilat përballlet sektori ndikon në alokimin më racional të resurseve.
- E treta, ka avantazhe të rëndësishme në kuptimin e efikasitetit, që rezultojnë nga raportimi i përbashkët, reduktimi i transaksioneve dhe i duplikimit.

Cilat janë kostot?

Qasjet e bazuara në programe ose në të gjithë sektorin padyshim janë më komplekse se projektet zhvillimore të ndara, dhe si të tilla kërkojnë më shumë kohë dhe punë. Kjo mund të ketë implikime të rëndësishme kur bëhet fjalë për arritjen e rezultateve të shpejta me qëllim të kapjes së momentit për realizimin e reformave. Nevoja për të arritur një marrëveshje me subjektet relevante dhe të gjithë donatorët mund ta vështirësojë procesin konsultativ dhe të marrë kohë. Barra më e madhe bie mbi agjensinë kryesore qeveritare dhe kriteri kyç për arritjen e suksesit është që kjo agjensi të ketë kapacitetin e duhur për udhëheqjen e këtij procesi ose të ndihmohet në zhvillimin e këtij kapaciteti.

Aneksi 3: Aplikimi i Deklaratës së Paris mbi Efektivitetin e Ndhmës në Financimin e Investimeve në Statistikë

Deklarata e Paris mbi Efektivitetin e Ndhmës, e miratuar më 2 mars të vitit 2005, është një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar nga mbi njëqind ministri, udhëheqës agjensish dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Ata u përkushtuan për menaxhim, harmonizim dhe përputhshmëri më të madhe të programeve të tyre të ndihmës me qëllim të arritjes së rezultateve të matshme duke ndërmarrë veprime të monitorueshme dhe duke shfrytëzuar indikatorë për matjen e progresit. Në veçanti, Deklarata i obligon nënshkruesit e saj për pesë parime kryesore:

- Pronësia, ku vendet partnere ushtrojnë lidhshmëri efektive mbi politikën dhe strategjinë zhvillimore dhe koordinojnë në mënyrë aktive aktivitetet zhvillimore;
- Përputhshmëria, ku donatorët bazojnë përkrahjen e tyre të përgjithshme në institucionet, procedurat dhe strategjinë zhvillimore nacionale të vendeve në fjalë;
- Harmonizimi, për të siguruar që aktivitetet e donatorëve janë më të harmonizuara, më transparente dhe më efektive në kuptimin kolektiv;
- Menaxhimi i rezultateve, që nënkupton përmirësimin e vendimmarrjes dhe të resurseve me qëllim të arritjes së rezultateve të matshme; dhe
- Llogaridhënia reciproke, për të siguruar që donatorët dhe partnerët janë përgjegjës për rezultatet zhvillimore.

Është e qartë që statistikën janë të rëndësishme për implementimin dhe monitorimin e Deklaratës së Parisit në kuptimin që aktivitetet e sistemeve statistikore nacionale janë esenciale për përkrahjen e vendimmarrjes për arritjen e rezultateve zhvillimore dhe janë një nga mekanizmat kryesorë për monitorimin e progresit. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të shikohet se si mund të aplikohen këto parime në programe dhe projekte, që përkrahin ndërtimin e kapacitetit statistikor dhe, në veçanti, të sigurohet që ato përbëjnë bazën e çfarëdo iniciative që ka për qëllim rritjen e përkrahjes së donatorëve. Ka lidhje të forta në mes të Planit të Veprimit të Marrakech për Statistika, Parimeve të Statistikave Zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratës së Parisit. Me një fjalë, aplikimi i parimeve të Deklaratës së Paris në rritjen e investimeve në statistikë nënkupton të mëposhtmet.

- Pronësia nënkupton që vendet në zhvillim kanë pronësi dhe ushtrojnë lidhshmëri efektive në sistemet e tyre statistikore dhe donatorët e respektojnë këtë.
- Përshtatja e përkrahjes së donatorëve ndodh atëherë kur vendet në zhvillim përgatisin dhe implementojnë korniza strategjike dhe programe efektive për zhvillimin e statistikave nacionale (SNZhS ose dokumente të ngjashme) dhe kur donatorët ofrojnë përkrahje teknike dhe financiare brenda kontekstit të këtyre strategjive.

□ Harmonizimi nënkupton që vendet në zhvillim të ushtrojnë leadership efektiv në koordinimin e asistencës së donatorëve dhe donatorët të harmonizojnë aktivitetet e tyre përmes projekteve dhe programeve të planifikuara dhe të koordinuara si duhet.

□ Menaxhimi për rezultate nënkupton që SNZhS duhet të dizajnohen jo vetëm për të siguruar të dhëna më të mira statistikore, dhe indikatorë, por gjithashtu për të siguruar që këto të dhëna ndihmojnë vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

□ Llogaridhënia reciproke nënkupton që vendet në zhvillim dhe donatorët të jenë dakord për monitorimin e implementimit dhe rezultateve të SNZhS brenda kontekstit të llogaridhënies reciproke, duke pasur parasysh që krijimi i një sistemi statistikor të qëndrueshëm mund të marrë kohë të gjatë. Të gjithë partnerët duhet të dakordohen rreth indikatorëve dhe afateve për monitorimin e realizimit të aktiviteteve, arritjes së rezultateve, ndikimit të statistikave më të mira dhe të sistemit statistikor më efektiv. Gjithashtu, duhet të arrihet një marrëveshje lidhur me qëllimet që duhet të arrihen dhe veprimet që duhet të ndërmerren kur implementimi nuk shkon si duhet.

Kontributi i partnerëve të ndryshëm në rritjen e përkrahjes në statistikë dhe aplikimi i këtyre parimeve përmbledhet në tabelën në vijim.

Partnerët	Nevojat	Rolet	Kontributet
Politikë-bërësit e vendeve në zhvillim	Statistika të cilësisë së mirë	të Vendimet bazuara në evidencë Përkrahja financimi Shfrytëzimi statistikave	e Njohja e rëndësisë së statistikave dhe Ofrimi i financimit të mjaftueshëm i dhe të parashikueshëm Përkrahja e pavarësisë së agjensive statistikore
Statisticientët e vendeve në zhvillim	Statisticientë të kualifikuar, të motivuar Përkrahje politike e nivelit të lartë Resurse, Standarde Asistencë teknike	të Vizion dhe strategji sistemin statistikor nacional Statistika relevante, të cilësisë së mirë	Përforcimi i leadershipit dhe menaxhimit Koordinim më i mire në sistemin statistikor nacional Implementimi i këshillave teknike relevante dhe praktikave të mira

Partnerët	Nevojat	Rolet	Kontributet
Politikë-bërësit dhe donatorët në vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	Statistika të cilësisë së mirë	Vendime të bazuara në fakte Avokim për statistika Shfrytëzimi i të dhënave Ndihmë financiare	Theksimi i rezultateve në programet e ndihmës. Të përqëndruarit në zhvillimin e kapacitetit statistikor dhe në nevojën për të dhëna Koordinim më i mirë i donatorëve Marrëveshje rreth asaj se si do të matet progresi
Politikë-bërësit dhe donatorët në vendet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim	Përkrahje nga agjensitë nacionale	Avokim për zhvillimi i metodologjisë keshilla dhe trajnime	Paraqitja e rolit të asistencës teknike në objektivat e organizatave statistikore nacionale Identifikimi i nevojave dhe mangësive të prodhuesve të dhënave
Politike-beresit nderkombetar/r egjional dhe donatoret	Statistika të cilësisë së mirë	Avokim për statistikave Shfrytëzimi i statistikave Financimi	Përkrahja e rezultateve në programet e ndihmës Të përqëndruarit në zhvillimin e kapacitetit statistikor dhe në nevojën për të dhëna Koordinim më i mirë i donatorëve
Statisticientet nderkombetare/ Regjionale	Statistika të cilësisë së mirë Resurset	Avokimi Standardet ndërkombëtare Të dhëna nga vendet e	Të përqëndruarit në ndërtimin e kapacitetit statistikor, si dhe në nevojat

Partnerët	Nevojat	Rolet	Kontributet
		krahasueshme Asistenca teknike	immediate për të dhëna Të përqëndruarit në prioritete nacionale Koordinim më i mire në mes të agjensive
Analistë, etj.	Statistika të cilësisë së mirë	Ngritja e vetëdijes resurset teknike dhe financiare	Ndërveprim më i madh me prodhuesit e të dhënave dhe sistemet e qeverisjes

